

VENDIM
Nr. 197, datë 4.3.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 245, DATË 29.3.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN ME QIRA, ME TARIFË TË REDUKTUAR, TË
SALLËS SË KONCERTEVE TË PALLATIT TË KONGRESEVE, TEATRIT
KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës së mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 245, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, viti “2019” zëvendësohet me “2020”.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama